



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 124 prot.

Kamëz, më 17.08.2022

V E N D I M

Nr. 106 Datë 17.08 2022

M B I

“NDRYSHIMIN NË VENDIMIN NR. 5 DATË 27.01.2022 TË  
KËSHILLIT BASHKIAK KAMËZ “PËR KRIJIMIN DHE ORGANIZIMIN E  
NDËRMARRJES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 17.08.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.94 Datë 17.08.2022 në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësisve të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit nr.5 datë 17.01.2022 të Këshillit Bashkiak Kamëz “Mbi krijimin, organizimin, dhe funksionimi e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin në pikën 2 të VKB nr. 5 datë 17.01.2022 “Mbi krijimin, organizimin, dhe funksionimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike” shtohet në detyrat kryesore të ndërmarrjes edhe: **- Administrimi dhe mirëmbajtja e tregjeve publike në territorin e Bashkisë Kamëz;**
2. Mënyra e përlllogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, që u ofrohen subjekteve të treta, përcaktohen me Vendim të Këshillit Bashkiak;
3. Ngarkohen Drejtoria e Financës; Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

NËN/ KRYETAR KËSHILLI

Ali DAUTI

